



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 312, datë 11.09.2020

PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË GJYQTARËVE QË DO TË CAKTOHEN PËR TË
GJYKUAR ÇËSHTJE GJYQËSORE URGJENTE NË GJYKATËN E RRETHIT
GJYQËSOR KURBIN

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 4, pika 3, nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 dhe 89 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 311, datë 11.09.2020, “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, në lidhje me nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin”, mbi rezultatet e shortit të hedhur për këtë qëllim,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së gjyqtarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë (Seksioni Penal), Krujë dhe Lezhë, që caktohen për gjykuar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjet gjyqësore urgjente, në lëndë penale dhe civile, të regjistruara për periudhën deri më datë 30.09.2020, si më poshtë:
 1. Për çështjet e regjistruara në datat 11 dhe 12 shtator 2020 – gjyqtare {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë);
 2. Për çështjet e regjistruara në datat 13 dhe 14 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë);
 3. Për çështjet e regjistruara në datat 15 dhe 16 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë);
 4. Për çështjet e regjistruara në datat 17 dhe 18 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë);
 5. Për çështjet e regjistruara në datat 19 dhe 20 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë);
 6. Për çështjet e regjistruara në datat 21 dhe 22 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë);
 7. Për çështjet e regjistruara në datat 23 dhe 24 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë);
 8. Për çështjet e regjistruara në datat 25 dhe 26 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin);
 9. Për çështjet e regjistruara në datat 27 dhe 28 shtator 2020 - gjyqtari {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë);

10. Për çështjet e regjistruara në datat 29 dhe 30 shtator 2020 – gjyqtare {...} (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë);

2. Ky vendim i njoftohet gjyqtarëve të caktuar sipas pikës 1, gjykatave respektive ku ato ushtrojnë funksionin dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR